



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-034
Prishtinë, më 22 qershor 2018, në orën 9:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 22 QERSHOR 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Mufera Srbica-Shinik.

Nga grupet parlamentare: Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi, Enver Hoti dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit: Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj, Musli Krasniqi dhe Osman Shatri.

Nga EUSR: Blerta Bejtullahu.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara më 6, 8 dhe 14 qershor 2018,
3. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara më 14 dhe 19 qershor 2018,
4. Përgatitjet për seancë plenare të radhës dhe
5. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

* * *

Në fillim, kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, për seancë të jashtëzakonshme për ta shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi të mbajë seancë të jashtëzakonshme, të enjten, më 28 qershor 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme së Kryesisë së Kuvendit

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 12 qershor 2018.

2. Vazhdimi i seancave plenare me pikat e papërfunduara më 6, 8 dhe 14 dhe 19 qershor 2018

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e papërfunduara nga seancat plenare, të mbajtura më 6, 8, 14 dhe 19 qershor 2018.

Kryesia, me propozim të kryetarit, vendosi që seancat plenare me pikat e papërfunduara më 6, 8, 14 dhe 19 qershor 2018, t'i vazhdojnë punimet të enjten, më 28 qershor 2018, në orën 12:00, si në vijim:

I. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara më 6, 8 dhe 14 qershor 2018, me këtë:

Rend dite

1. *Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës,*
2. *Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në lidhje me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës,*
3. *Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në lidhje me vendimet e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nenad Rikalo, për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencione.*

II. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara më 14 dhe 19 qershor 2018, me këtë:

Rend dite

3. *Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca e ministres së Integritit Evropian, znj. Dhurata Hoxha në lidhje me zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) për kuartalin e katërt (K4) 2017 dhe kuartalin e parë (K1) 2018,*
4. *Votimi në parim i Projektligjit për aktet juridike,*
5. *Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale,*
6. *Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave,*
7. *Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-037 për tatimin në vlerën e shtuar,*
8. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,*
9. *Votimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017,*
10. *Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017,*
11. *Votimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin 2017,*
12. *Votimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017,*
13. *Propozimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyeseve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës,*

14. Propozimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq, më 29 mars 2018,

15. Debat parlamentare në lidhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021.

4. Përgatitjet për seancë plenare të radhës

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e rendit të ditës që i plotësojnë kushtet për shqyrtim në seancë plenare, si dhe me dy projektligjet e proceduara në ndërkohë.

Me pëlqimin e kryetarëve të GP të LVV-së, Glauk Konjufca, dhe GP të LDK-së, Avdullah Hoti, Kryesia e Kuvendit vendosi që në seancën plenare të radhës të zhvillohet vetëm një interpelancë për kryeministrin, sipas kërkesës së GP të LVV-së dhe GP të LDK-së, në lidhje me vendimin e Qeverisë nr.01/50, datë 5. 6. 2018 për pagesën e 53 milionë eurove shtesë për kompaninë Bechtel&Enka në Kontratën për ndërtimin e Autostradës R6 “Arbën Xhaferi”, Prishtinë - Hani i Elezit.

Pastaj, Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të enjten, më 5 korrik 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP të Lëvizjes Vetëvendosje dhe GP të LDK-së, në lidhje me vendimin e Qeverisë nr.01/50, datë 5. 6. 2018 për pagesën e 53 milionë eurove shtesë për kompaninë Bechtel&Enka në Kontratën për ndërtimin e Autostradës R6 “Arbën Xhaferi”, Prishtinë - Hani i Elezit,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-079 për Eficiencë të energjisë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbime postare,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat mbrojtëse në importe.
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2017,
9. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për miratimin e buxhetit të këtij komisioni,
10. Propozimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Ndërkohë, rendi i ditës mund të plotësohet edhe me pika tjera, të cilat i plotësojnë kushtet për procedim deri më 2 korrik 2018.

5. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Nisma legislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës”, hartuar nga Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim

Kryesia, pasi e shqyrtoi nismën legislative për “Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës”, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

2. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-176 për hetim parlamentar, hartuar nga nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti, mbështetur edhe nga 11 deputetë

Kryesia, pasi e shqyrtoi procedimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-176 për hetim parlamentar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-176 për hetim parlamentar u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, si komision funksional, që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

3. Procedimi i Projektligjit për peticione, hartuar nga deputetja Albulena Haxhiu, mbështetur edhe nga 10 deputetë të GP të Lëvizjes Vetëvendosje

Kryesia, pasi e shqyrtoi procedimin e Projektligjit për peticione, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për peticione u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, si komision funksional, që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe

Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

4. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës, hartuar nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryesia, pasi e shqyrtoi procedimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, si komision funksional, që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime, para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

5. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për miratimin e buxhetit të këtij komisioni, si dhe për zgjatjen e mandatit (afatit)

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për miratimin e buxhetit të këtij Komisioni, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, që ta shqyrtojë kërkesën e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për miratimin e buxhetit dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryesia, po ashtu kërkesën e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për zgjatjen e mandatit (afatit) e radhiti në rend dite për seancën plenare më 5 korrik 2018.

6. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqërisë Kulturo-Artistike etnologjike "Talentët e rinj", Prizren, për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Shoqëria Kulturo-Artistike Etnologjike “Talentët e rinj”, Prizren, mbështetet financiarisht në shumën prej 2 000 euro për organizimin e Festivalit të 5-të Rajonal të Folklorit multikulturor, multietnik dhe etnologjik, i cili do të mbahet më 25-26 qershor 2018.

7. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesat buxhetore të Kuvendit për vitet 2019-2021, në bazë të Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave 2019/01

Kryesia, pasi e shqyrtoi Rekomandimin e lartshënuar të Komisionit për Buxhet dhe Financa, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohen kërkesat buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitet 2017-2021.

2. Ministrisë së Financave i rekomandohet që të njëjtat kërkesa t’i përfshijë në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitet 2019-2021.

8. Shqyrtimi i kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të biletave të udhëtimit për vizitën zyrtare në Panama

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Shpenzimet e biletave të udhëtimit për deputetët Elmi Reçica dhe Rexhep Selimi, në shumën prej 3,245.50 euro për një biletë (në bazë të rezervimit), lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar në Panama, nga 25 qershor deri më 1 korrik 2018 mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

9. Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e udhëtimit zyrtar në Belgjikë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Driton Selmanaj, Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Blerta Deliu-Kodra dhe Avdullah Hoti u lejohet udhëtimi zyrtar në Bruksel (Belgjikë), prej 10-13 korrik 2018.

10. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Ismet Beqiri për lejimin e udhëtimit zyrtar në SHBA

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ismet Beqiri, i lejohet udhëtimi zyrtar në Nju-Jork (SHBA), prej 9-19 korrik 2018.

11. Shqyrtimi i kërkesës së kryetares së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, znj. Duda Balje, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Maqedoni

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Sasha Milosavljeviq, Saranda Bogujevci, Mexhide Mjaku-Topalli, Mirjeta Kalludra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu, Albulena Balaj-Halimaj dhe Fisnik Ismaili u lejohet udhëtimi zyrtar në Maqedoni, prej 28-29 qershor 2018.

Kryesia, po ashtu lidhur me kërkesën e lartshënuar, vendosi që udhëtimi zyrtar të realizohet pas përfundimit të seancës plenare, të caktuar për 28 qershor 2018.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 9:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale